



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 744/12 Prot.

Tiranë, më 10/01/2024

VENDIM

Nr. 3, DATË 10/01/2024

MBI

“MIRATIMIN E PËRCAKTIMEVE TË KONTRIBUTIT NË KËRKIMIN SHKENCOR DHE KRIJIMTARINË ARTISTIKE TË STAFIT AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË NË FAKULTETIN E MUZIKËS, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 3, në nenin 93 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 6, 24, 64 dhe 116 e vijues të Statutit të Universitetit të Arteve, në shkresën nr. 744/1 prot., datë 20.11.2023 të Dekanatit të Fakultetit të Muzikës, me lëndë “*Kthim përgjigje shkresës nr. 744, datë 08.09.2023*” si dhe pas diskutimeve, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin e përcaktimeve të kontributit në kërkimin shkencor dhe krijimtarinë artistike të stafit akademik me kohë të plotë në Departamentin KMDP, në Departamentin e Interpretimit si dhe në Departamentin e Kantos në Fakultetin e Muzikës, në Universitetin e Arteve, sipas materialit bashkëngjitur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Artan PEQINI

Prof. Arben LLOZI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Genci FUGA

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Asoc. Dr. Artan IBËRSHIMI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Erlind FUSHA (Student FAB)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANATI

Nr. 744/1

Tiranë, më 20/11/2023

Lenda : Kthim përgjigje shkresës Nr 744 datë 8.09.2023

Zv.Rektor

Prof. Dr. Erald Bakalli

Universiteti i Arteve

Sheshi "Nënë Tereza" Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj Nr.744, datë 8.09.2023, po ju dërgojmë përcaktimet e kontributit në kërkimin shkencor dhe krijimtarinë artistike të stafik akademik me kohë të plotë për Departamentin KMDP, Departamentin e Interpretimit si dhe Departamentin e Kantos.

Bashkëngjitur gjeni dokumentacioni përkatës.

Prof.Dr. Isak SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI I INTERPRETIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____ /2023

Lënda: Mbi llogaritjen e orëve për aktivitetin artistik dhe shkencor

PROF. DR. ERALED BAKALLI
ZV.REKTOR
UNIVESITETI I ARTEVE

I Nderuar Zoti Zv.Rektor,

Në përgjigje të shkresës tuaj “Mbi dërgimin për miratim në Senatin Akademik të përcaktimeve të kontributit në kërkimin shkencor dhe krijimtarinë artistike të stafit akademik në Universitetin e Arteve”, po ju përcjell bashkëlidhur propozimet e Departamentit të Interpretimit si më poshtë:

1. Shtojca A: Tabela e veprimtarisë për interpretuesit;
2. Shtojca B: Tabela e veprimtarisë për kërkimin shkencor.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

Me konsideratë,

Prof. Arben LLOZI

PËRGJEGJËS I NJËSISË BAZË

SHTOJCA A

Nr. i referencës	Titulli i punës	Aktiviteti
1	Koncert Recital; Koncert i plotë Duo/Muzikë Dhomë; Solist shogëruar me orkestrë/ansambël; Drejtor Artistik; Dirigjent i ansambleve/orkestrave të dhomës; Kompozitor i veprave instrumentale/vokale	aktivitet
2	Pjesëmarrje në koncerte si solist apo në ansambël; spale sektori në orkestrë/ansamble; Kompozitor i këngëve	aktivitet
3	Drejtimi si dirigjent i një Opera/Simfoni;	aktivitet
4	Drejtimi i Master-Class-eve dhe Workshop-eve	aktivitet
5	Anëtar Jurie në konkurse/festivale	aktivitet

SHTOJCA B

	Aktiviteti i Zhvilluar	Përmbajtja	Orë Gjithsej
1	Monografi shkencore (si autor i parë)	200-300 faqe	2000-3000 orë
2	Monografi shkencore (bashkautor)	200-300 faqe	1000-2000 orë
3	Artikuj në revista dhe periodike shkencorë (shqip)	8-20 faqe	200-400 orë
4	Artikuj në revista dhe periodike shkencorë (në gjuhë të huaj)	8-20 faqe	250-500 orë
5	Artikuj kritikë/informues në gazeta dhe periodike (shqip)		60 orë
6	Përkthim në shqip (monografi shkencore, tekste të lëndëve)	200-300 faqe	400-600 orë
7	Përkthim në gjuhë të huaj (monografi shkencore, tekste të lëndëve)	200-300 faqe	600-900 orë
8	Përkthim në shqip (artikuj shkencorë)	8-20 faqe	16-40 orë
9	Redaktues shkencor i një monografie	200-300 faqe	100-150 orë
	PJESËMARRJE NË AKTIVITETE SHKENCORE (KOMBËTARE & NDËRKOMBËTARE)	Njësia	Orë Gjithsej
1	Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore (seminare, kongrese, konferenca)	artikull	50 orë
	Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore (seminare, kongrese, konferenca)	aktivitet	20 ore
	Pjesëmarrje si vlerësues (peer reviewer) i artikujve shkencorë (seminare, kongrese, konferenca)	artikull	20-30 orë
	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore (seminare, kongrese, konferenca) si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues	konferencë	30-40 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI KMDP

Tiranë, më 12.09.2023

Lënda: Kthim përgjigje shkresës Nr.744, datë 8.09.2023

Drejtuar : Dekanit të Fakultetit të Muzikës
Prof. Dr. Isak Shehu
Universiteti i Arteve
Sheshi Nënë Tereza

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.744, datë 8.09.2023, me tonën, datë 11.09.2023, Nr. 455.Prot, po ju informojmë si më poshtë:

Njësia Bazë KMDP, ka evidentuar prej kohësh nevojën e rishikimit përsa i përket përcaktimit të kontributit artistik/shkencor të stafit akademik. Më konkretisht përgjatë muajit shkurt 2022, janë ndërmarrë një sërë takimesh me grupet mësimore dhe drejtuesit e grupeve mësimore me synim përcaktimin e veprimtarisë artistike dhe shkencore të stafit akademik. Në përfundim të këtyre takimeve është rënë dakort për përcaktimin e veprimtarisë artistike për specialistët e fushës së kompozimit, dirizhimit dhe muzikologjisë.

Bashkëlidhur po dërgojmë dokumentacionin përkatës.

Prof. Asoc. Dorian Çene
Përgjegjës i Njesisë Bazë KMDP

SHTOJCA A

	Lloji i veprës	Kohëzgjatja e përafërt	Ore Gjithsej
1	Instrument solo	deri në 12 minuta	70-120
2	Vokal dhe 1 (një) instrument	deri në 12 minuta	60-144
3	Vepër për kor <i>acapella</i>	deri në 12 minuta	128-192
4	Muzikë Dhome (2-9 instrumenta)	deri në 15 minuta	126-270
5	Muzikë për Ansambël (10-20 instrumenta)	deri në 15 minuta	230-460
6	Muzikë për orkestër dhome, fryme, big band etj (20-30 instrumenta)	deri në 45 minuta	260-1,040
7	Orkestër Simfonike	deri në 45 minuta	300-1,350
8	Opera me 1 akt	deri në 90 minuta	1620-3,240
9	Balet	deri në 90 minuta	900-2,700
10	Teatër	deri në 30 minuta	360-540
11	Muzike Filmi	deri në 40 minuta	400-800
12	Përshtatja (arranzhimi) e një vepre, sipas përcaktimeve të pikave 1,2,4, në vepra sipas përcaktimeve të pikave 5,6,7 përllogaritet me 1/3 e orëve të veprës me përmbajtjen më të madhe instrumentale.		
13	Përshtatja (arranzhimi) e një vepre për formacione të ndryshme, përjashtuar rastet e parashikuara në pikën 12, përllogaritet me 1/3 e orëve të veprës së kompozuar.		
14	Për rastet kur shtohet një instrument solistik, pika 3-7, totali orëve shumëzohet me koeficientin 1.2.		
15	Për rastet kur shtohet elektroakustikë (e pregatitur ose në kohë reale [live electronics], pika 1-8, totali orëve shumëzohet me koeficientin 1.1.		

SHTOJCA B

	Aktiviteti	Njësia	Ore Gjithësej
1	Drejtimi i një ansambli, bande, orkestre simfonike (vepra të ndryshme simfonike)	aktivitet	120
2	Drejtimi i një Opere	aktivitet	240
3	Drejtimi i ansambleve/ bandave (në kuadër të aktiviteteve protokollare	aktivitet	40

SHTOJCA C

	Aktiviteti i Zhvilluar	Përmbajtja	Ore Gjithsej
1	Monografi shkencore (si autor i parë)	200-300 faqe	2000-3000 orë
2	Monografi shkencore (bashkautor)	200-300 faqe	1000-2000 orë
3	Artikuj në revista dhe periodike shkencorë (shqip)	8-20 faqe	200-400 orë
4	Artikuj në revista dhe periodike shkencorë (në gjuhë të huaj)	8-20 faqe	250-500 orë
5	Përkthim në shqip (monografi shkencore, tekste të lëndëve)	200-300 faqe	400-600 orë
6	Përkthim në gjuhë të huaj (monografi shkencore, tekste të lëndëve)	200-300 faqe	600-900 orë
7	Përkthim në shqip (artikuj shkencorë)	8-20 faqe	16-40 orë
8	Redaktues shkencor i një monografie	200-300 faqe	100-150 orë
	PJESËMARRJE NË AKTIVITETE SHKENCORE (KOMBËTARE & NDËRKOMBËTARE)	Njësia	Ore Gjithsej
1	Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore (seminare, kongrese, konferenca)	artikull	50 orë
2	Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore (seminare, kongrese, konferenca)	aktivitet	20 ore
3	Pjesëmarrje si vlerësues (peer reviewer) i artikujve shkencorë (seminare, kongrese, konferenca)	artikull	20-30 orë
4	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore (seminare, kongrese, konferenca) si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues	konferencë	30-40 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI I KANTOS

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 12.09.2023

Lenda : Kthim përgjigje shkresës Nr : 744, datë 8.09.2023

Drejtuar : Dekanit të Fakultetit të Muzikës

Prof. Dr. Isak Shehu

Universiteti i Arteve

Sheshi Nënë Tereza

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 744, datë 8.09.2023 ju informojme si më poshtë :

Njësia Bazë Kanto, ka evidentuar prej kohësh nevojën e rishikimit përsa i perket përcaktimit të kontributit artistik /shkencor të stafit akademik.

Më konkretisht përgjatë muajit Shkurt 2022, janë ndërmarrë një sërë takimesh me grupet mësimore dhe drejtuesit e grupeve mësimore me synim përcaktimin e veprimtarisë artistike dhe shkencore të stafit akademik.

Në përfundim të këtyre takimeve është rënë dakord dhe përcaktuar veprimtaria artistike për specialistet e fushës së Këngëtarit Lirik.

Bashkalidhur gjeni dokumentacionin përkates.

Përgjegjësi i Njesisë Bazë Kanto

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Lloji i Vepres/Roli	Kohezgjatja e perafert	Ore gjithsej
1 - Romance/Lied/Kenge qytetare ose popullore e perpunuar	Deri ne 6 minuta	30 ore
2 - Arie nga repertori Operistik (Veper e plote ku perfshihet interpretimi Arie-ve me Recitativ/Andante/Cabaletta)	Deri ne 20 minuta	80 ore
3 - Koncert ne bashkepunim/ Muzike Dhome	Deri ne 60 minuta	150 ore
4 - Koncert Recital	Deri ne 80 minuta	300 ore
5 - Role dytesore/episodike ne nje veper Operistike	Deri ne 180 minuta	200 ore
6 - Role kryesore ne nje veper Operistike	Deri ne 180 minuta	2000 ore